



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ATTORNEYS CHAMBER OF KOSOVA
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

R R E G U L L O R E
PËR LICENCIMIN E AVOKATËVE TË HUAJ

PRISHTINË
29 tetor 2011

Ne baze te nenit 39.1.7 te Ligjit mbi Avokatinë Nr. 03/L-117 (Gz. Kosovës, nr.49/2009 date 25 mars 2009), me qellim te sigurimit se te pandehurit ne procedure penale dhe palët ne gjykim ne procedura te caktuara, te kenë qasje me te madhe ne shërbimet e avokatit sipas zgjedhjes se vet,Kuvendi i Odes se Avokateve te Kosovës, ne Mbledhjen e vet te mbajtur me datën 29 tetor 2011, nxjerr:

RREGULLORE PËR LICENCIMIN E AVOKATËVE TË HUAJ

Neni 1-Definicionet

Për qellim te kësaj rregulloreje:

- (a) “procedure”i referohet çdo faze te procesit gjyqësor nga fazat fillestare deri te vendimi përfundimtar;
- (b) “avokate te huaj” është një avokat qe si i pajisur me Licence për ushtrimin e profesionit ligjor ne shtetin e origjinës, ne përputhje me këtë rregullore ka arritur te drejtën për ndihmën klientëve ne çështjeve ligjore ne Kosove.
- (c) “Licencimi për avokatin e huaj” ka te beje me lejen e dhëne te avokatit te huaj qe te merret me avokature ne Kosove dhe qe është i autorizuar ta ushtroje avokaturën me ligjin e zbatueshëm ne Kosove

Neni 2 -Autoriteti licencues

2.1 Autoriteti qe është përgjegjës qe te regjistroje dhe te licencoje avokatet e huaj për ushtrimin e çështjeve ligjore ne Kosove është Oda e Avokateve te Kosovës(OAK)

2.2 OAK mund te japë një Licence te kufizuar avokatit te huaj [LKH] nen kushtet e veçanta te përcaktuara me këtë Rregullore, duke autorizuar atë qe te shërbejë ne:

- (a) procedure penale,apo
- (b) procedure civile qe ndërthen ligjet apo standardet ndërkombëtare

2.3 OAK mund te jap Licence te përhershme avokatit te huaj [LPH], nëse avokati demonstroi nevojën e tij qe do te angazhohet ne ushtrimin e çështjeve ligjore ne Kosove

Neni 3-Procesi i kërkesës

3.1 Për te fituar Licencën, avokati i huaj duhet te paraqes një kërkesë ne Oden e Avokateve te Kosovës, qe përbëhet prej :

- (a) Aplikacioni për Licence për te shërbyer si avokat ne Kosove,duke specifikuar fushën, çështjet apo një procedure te specifikuar

- (b) Marrëveshje me shkrim si bashkë-avokat duke e përcaktuar lidhjen e propozuar profesionale mes avokatit të vendit dhe atij të huaj e nënshkruar nga të dy avokatet
- (c) Dokumentet mbështetëse për të demonstruar që është i pajisur me Licence për ushtrimin e profesionit ligjor në shtetin e origjinës dhe
- (d) Kalimin me sukses të Provimit të pranimit

3.2 Kërkuesi duhet të përfshijë dokumente mbështetëse për të demonstruar se avokati i huaj i plotëson kushtet nga pika 3.1.c):

- (a) Me kushtet e reciprocitetit, ashtu që me rastin e aplikimit për licencim avokati i huaj duhet odes të paraqes dëshmi nga autoriteti kompetent për regjistrimin e avokateve sipas se cilit avokatet e Republikës së Kosovës mbi baza të njëjta mund të pajisen me licence të avokatit në vendin nga i cili është aplikanti.
- (b) Avokatet të cilët deri më tani janë të pajisur me licence mund ta ushtrojnë profesionin e avokatit të regjistruar në OAK deri më datën 1 janar 2012, sipas kushteve me të cilat janë regjistruar. Deri në datën e cekur duhet ta dëshmojnë reciprocitetin, në të kundërtën do të pason shlyerja ex-officio e tyre nga Regjistri i avokateve të huaj në OAK..
- (c) të jete i licencuar për avokat në juridiksionin e shtetit të vet;
- (d) nuk është nën procedurat disiplinore të organit profesional ose drejtues i juridiksionit tjetër; dhe
- (e) ka të paktën 5 vite përvojë si avokat.

Dokumentet mbështetëse duhet të përfshijnë këto:

- (i) një kopje të vërtetuar të licencës për tu marrë me drejtësi i lëshuar nga organi profesional kompetent apo ai drejtues në juridiksionin e vendit nga vjen avokati dhe
- (ii) një deklaratë të vërtetuar nga organi profesional kompetent apo drejtues në juridiksionin e vendit nga vjen avokati që avokati nuk është shkarkuar dhe nuk është subjekt i procedurës disiplinore.

3.3. OAK do të verifikojë dokumentacionin mbështetës dhe do të marrë një vendim brenda 15 ditësh për raste penale dhe brenda 30 ditësh për raste civile, për nënshtrimin e Provimit të Pranimit në Ode.

Neni 4. Provimi i Pershatshmerisë në Oden e Avokateve të Kosovës [PPO]

4.1. Para fitimit të çfarëdo Licencimi për ushtrimin e punëve ligjore avokati i huaj duhet të kalojë Provimin e pershatshmerisë, të organizuar nga OAK.

4.2. PPO, përfshinë testimin e njohurive themelore

-njohje me sistemin juridik të Kosovës

-njohje me rregullat e procedurave nën të cilat trajtohet rasti i përfaqësuar

-njohje e kodit të etikës dhe sistemit disiplinor të OAK

4.3. Strukturën e PPO për avokatet e huaj e përcakton Bordi Drejtues i OAK

4.4. Bordi Drejtues i OAK emëron Komisionin e PPO të cilët gjithsesi duhet të jenë trajnues në KPA.

Neni 5. Licencimi

5.1. OAK do të miratojë kërkesën për Licence nëse kërkuuesi ka demonstruar që ai i plotëson kushtet në pjesën 3.2 dhe nëse OAK tashmë nuk i ka dhënë licence avokatit në rast të ndara.

5.2. Me miratimin e kërkesës së avokatit të huaj OAK do të lëshojë një Licence të re në formë të ID-kartelës .

5.3. Avokati i huaj duhet ta paraqes këtë dokument me rastin e kërimit nga ndonjë zyrtar i gjykatës.

5.4. Me rastin e licencimit, avokati i huaj është i detyruar që të paguaj edhe taksën, sikurse edhe pagesën vjetore për mbajtje të licencës, në lartësinë e përcaktuar nga Bordi i Drejtoreve

Neni 6 - Fushëtrirja e shërbimit

6.1. Avokati i huaj që e ka fituar Licencën në përputhje me këtë Rregullore ka të drejtë që të ofrojë ndihmë ligjore të gjithanshme duke përfshirë por jo duke u kufizuar, bërja e parashtresave me shkrim dhe me gojë në gjykate si dhe të drejtën për të pasur qasje të plote ndaj profesionit të përfaqësuesit në përputhje me kushtet e ligjit të zbatueshëm.

Neni 7- Kushti i bashkë-avokatit

7.1. Avokati i huaj që e ka fituar Licencën e përkohshme [LPH] në përputhje me këtë Rregullore, duhet të veprojë si bashkë-avokat i avokatit që është i regjistruar dhe i licencuar .

7.2. Avokati i huaj duhet të pranojë shërbimin e dokumenteve dhe korrespondencën zyrtare me adresën e biznesit të bashkë-avokatit vendor.

Neni 8- Kushtet disiplinore të procedurave

8.1. Ligji mbi Avokaturën, Kodi i Etikes, Statuti i OAK, si dhe çfarëdo standardi tjetër i zbatueshëm, i shpallur nga OAK do të vlejë për avokatet e huaj të pranuar në përputhje me këtë Rregullore.

8.2. Me rastin e dhënies së Licencës OAK do të udhëzojë avokatin e huaj që të parashtrojë një deklaratë me shkrim të nënshkruar që ai ka lexuar dhe nuk do të shkel standardet e zbatueshme të sjelljes profesionale.

8.3. OAK do të ketë autoritetin që të ndërmarr hetime me rastin e pohimeve si një avokat i huaj e ka shkelur standardet e zbatueshme të sjelljes së etikes profesionale dhe do të vlerësojë procedurat disiplinore të zbatueshme edhe për avokatet kosovar.

8.4 OAK mund te njoftoje organin relevant drejtues ne juridiksionin e vendit nga vjen avokati për procedurat disiplinore dhe për vendimet lidhur me to.

8.5. OAK do te bashkëpunoje plotësisht me organin relevant hetues nëse organi vendos te filloje hetimet me veprimet e avokatit te huaj ne Kosove.

8.6. Avokati i huaj është konstatuar se i ka shkelur standardet profesionale te sjelljes apo etikes ne lidhje me procedurat ne Kosove menjëherë do te shkarkohet nga detyra si bashkë-avokat ne procedure. Avokati i shkarkuar nuk mund te beje kërkesë për licence te përkohshme.

Neni 9 –Përjashtimi nga përfitimet publike ligjore

9.1. Avokati i huaj i pranuar ne përputhje me këtë rregullore nuk mund te marre pjese apo te fitoje nga asnjë skeme ndihme publike ligjore e parapare për dobinë e banoreve te Kosovës.

Neni 10- Regjistrat për Avokatet e Huaj

10.1. Oda e Avokateve te Kosovës themelon dhe udhëheq Regjistrat përkatës për avokatet e huaj.

10.2. Ne Regjistrat e Avokateve te Huaj regjistrohet përveç tjerash edhe licencimi,masat disiplinore, shlyerja dhe te dhënat e faktet e tjera te rëndësishme ne lidhje me këtë, ne mënyrën se si mbahen dhe udhëhiqen edhe regjistrat për avokatet vendore.

Neni 11-Hyrja ne fuqi

11.1. Kjo Rregullore hyn ne fuqi ditën e aprovimit ne Kuvendin e Odes se Avokateve te Kosovës, me datë 29.10.2011.

Prishtinë, datë: 29.10.2011

Kryetari
E ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
Ibrahim Dobruna, d.v.